

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR,
PROJEKTI “NDËRTIMI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN”

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për projektin “Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 30.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 150 datë 10.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 527/6 datë 10.11.2014, dërguar Z. Dashamir Xhika, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Raportet vjetore mbi kushtet financiare të agjentit dhe rezultatet e veprimeve të tij gjatë çdo viti financiar dhe më pas në përfundim, së bashku me një gjendje llogarie të audituar, duke përfshirë bilance, fitimin dhe humbjen për vitin financiar të mbyllur nuk janë dorëzuar por NJMP ka dorëzuar vetëm raporte progresive mbi shpenzimet e vetë njësisë në kundërshtim me pikën b, seksioni 10 i Ligjit nr. 10419, datë 26/05/2011 (trajtuar më hollësisht në faqet 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të hartojë dhe dorëzojë raportet vjetore mbi kushtet financiare të agjentit dhe rezultatet e veprimeve të tij gjatë çdo viti financiar dhe më pas në përfundim, së bashku me një gjendje llogarie të audituar, duke përfshirë bilance, fitimin dhe humbjen për vitin financiar të mbyllur, në përputhje me pikën b, seksioni 10 i Ligjit nr. 10419, datë 26/05/2011.

Çdo vit

2. Raportet vjetore të audituesit të pavarur për pasqyrat e projektit nuk janë dërguar brenda afatit të parashikuar në marrëveshje në kundërshtim me pikën b, seksioni 10 i Ligjit nr. 10419, datë 26/05/2011.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të dorëzojë raportet vjetore të audituesit të pavarur për pasqyrat e projektit brenda afatit të parashikuar në marrëveshje në kundërshtim me pikën b, seksioni 10 i Ligjit nr. 10419, datë 26/05/2011.

Vazhdimisht

3. Plani i financimi të projektit është ndryshuar dhe është vepruar me këtë plan pa marrë miratimin nga Ministria e Financave duke përdorur fondet e kredisë në kundërshtim me ligjin 10419, datë 26.05.2011.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të propozojë dhe të kërkojë miratimin nga Ministria e Financave dhe nga financuesit e projektit rialokimin e fondeve sipas zërave të parashikuar në planin financiar.

Brenda muajit dhjetor 2014

4. Janë kryer pagesa të detyrimeve institucionale për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga fondi i kredisë, vlerë e cila është rimbursuar në një moment të dytë nga ARrSh. Kjo pagesë nuk përfshihet në planin e financimit të projektit, pagesa e kryer është në kundërshtim të përshkruar në Ligjin nr. 10419, datë 26.5.2011.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të mos kryejë asnjë pagesë të pa parashikuar në planin financiar të përshkruar në Ligjin nr. 10419, datë 26.5.2011.

Vazhdimisht

5. Nga auditimi ka rezultuar se dosjet e procedurave të prokurimit për projektin “Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan”, nuk janë inventarizuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Për këtë rekomandojmë:

NJMP në ARRSH, të marrë masa për të inventarizuar dosjet e prokurimit për projektin “Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan”, sipas ligjit nr. 9154, date 6.11.2003 për arkivat.

Brenda muajit nëntor 2014.

6. Në procedurën e prokurimit “Zgjedhja e Audituesit për projektin “Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan”, në urdhrin nr. 57/2, datë 22.07.2011 [REDAKTUAR] rezulton njëkohësisht anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe anëtare e Njesisë së Prokurimit sipas urdhrin për ngritjen e KVO nr. 2209, datë 21.12.2012 dhe urdhrin për ngritjen e KVO nr. 2209/1, datë 26.03.2013, duke përbërë shkak për konflikt interesi në vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare, në kundërshtim me manualin e IDB, pika 1.1.3. Në urdhrin e prokurimit nr. 2209, datë 21.12.2012, nuk është përcaktuar lloji i procedurës së prokurimit dhe nuk është cituar fondi limit për tenderin që do zhvillohet duke u mjaftuar me planin financiar në total, sipas përcaktimeve në marrëveshjen për ndërtimin e rrugës Tiranë – Elbasan, në kundërshtim me manualin e IDB , pika 1.1.3, kjo ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit dhe titullarin e autoritetit kontraktor.

-Në urdhrin e prokurimit për tenderin Zgjedhja e konsulentit për segmentin 1 + segmentin 3 në aksin rrugor Tiranë -Elbasan” nuk është përcaktuar lloji i procedurës dhe nuk është cituar fondi limit për prokurimin që është zhvilluar, duke u mjaftuar me planin financiar në total ,sipas përcaktimeve në marrëveshjen për ndërtimin e rrugës Tiranë – Elbasan, në kundërshtim me manualin e IDB, pika 1.1.3, kjo ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit dhe titullarin e

autoritetit kontraktor, këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit dhe titullarin e autoritetit kontraktor.

Për këtë rekomandojmë:

NJMP në ARRSH, të marrë masa për zbatimin e manualeve udhëzuese për procedurat e prokurimit me financime të huaja, duke realizuar me transparencë dokumentacionet e prokurimit për të arritur cilësinë më të mirë të mundshme të shërbimeve nga kontraktuesit, sipas katër parimeve të prokurimit ekonomikiteti, efienca, mundësia e barabartë për çdo ofertues dhe transparenca e procesit të prokurimit.

Deri më datë 31.12.2014

7. Nga verifikimi i punimeve në objekt rezulton se ndarëset e trafikut kanë pësuar dëmtime të cilat vijnë si pasojë e aksidenteve, por ka dhe zmontime të elementëve të tyre nga persona të paidentifikuar. Këto dëmtime kryesisht ekzistojnë ndërmjet kilometrit 25.23 deri në kilometër 25.820, të kontratës nr. 3.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për njoftimin e organeve kompetente për vjedhjet dhe dëmet e shkaktuara periodikisht në segmentin rrugor Tiranë-Elbasan, kryesisht sa i përket veprave të artit.

Menjëherë

8. Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës nr. 12.2, rezulton se për Pikën 4 “Mbrojtje lumi”, zëri ri 82. a “Gabione me rrjetë të galvanizuar”, janë likuiduar 11,140 m³, për zërin analizë e re 82. b (gabion ne forme jastëku), janë likuiduar 10,952.5 m³.

Ndërsa për pikën 5 “Mbrojtje toke”, sipas zërit 82. c, janë likuiduar punime për 3924 m³ mure gabioni.

Sa më sipër rezulton se, për mure gabion është likuiduar më shumë sasia 6224 m³ mur gabioni (mur mbrojtje lumore) dhe 3513.5 m³ mur gabioni ne forme jastëku.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Konsulentin, të marrin masa dhe t'i kërkojnë kontraktorit, realizimin e një azhurnimi të saktë të volumeve të realizuara sipas kontratës nr. 3, Segmenti rrugor “Tunel-Elbasan”, jo vetëm për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi nga auditimi, por edhe për zërat e tjerë të punimeve.

Brenda muajit Nëntor 2014.

9. Afati i përfundimit të punimeve për kontratën nr. 1 (Sauk-Tunel) është shtyrë deri me datë 21.12.2014. Pavarësisht shtesës së afatit të përfundimeve të punimeve, bazuar në progresin e tyre, kur vetëm 5 km të këtij segmenti rrugor (në një anë) është bërë funksionale, do të kërkohet rishikim i programit për përfundimin në afatin e rishikuar.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, t'i kërkojë kontraktorit sipas kontratës nr. 1, të paraqesë një program të rishikuar të realizimit të punimeve, duke rritur angazhimin, me synimin e përfundimit të punimeve të kontratës brenda afatit të rishikuar.

Menjëherë

10. Nga auditimi ka rezultuar se sipas kontratës nr. 1 (Ndërtimi i segmentit rrugor Sauk-Tuneli i Krrabës), punimet po realizohen në segmente të shkëputura nga njëri tjetri. Po ashtu në disa seksione, qarkullimi i automjeteve bëhet në segmentin rrugor ekzistues. Nga verifikimi në vend rezultoi se nuk janë marrë masa të kënaqshme për parandalimin e aksidenteve kryesisht në këtë segment rrugor.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, t'i kërkojë kontraktorit të rrisë masat e sigurisë në segmentet rrugore në ndërtim, me qëllim shmangien e aksidenteve të mundshme, kryesisht për kontratën e parë “Sauk-Tuneli i Krrabës”, pasi në këtë segment ka ndërprerje të shumta dhe devijime të trafikut.

Vazhdimisht

11. Kanalet e tarracave në përgjithësi kanë pësuar çarje, por edhe dhënia e formës së këtyre kanaleve është bërë në varësi të terrenit dhe jo të formave gjeometrike të rregullta. Po ashtu në një gjatësi të konsiderueshme, kanalizimet e realizuara në anët e rrugës janë të pa pastruara nga aluvionet.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me konsulentin, t'i kërkojnë kontraktorit të marrë masa për riparimin e kanaleve të tarracave të dëmtuara (kontrata nr. 3). Po ashtu, me synim mbajtjen në kondicione të pranueshme, të kërkohet dhe të mbahet në mbikëqyrje mirëmbajtja e veprave të ndërtuara, pastrimi i kanaleve anësorë etj.

Menjëherë

12. Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt, ka rezultuar se ndarëset e trafikut prej betoni kanë pësuar dëmtime kryesisht nga kilometri 25.23 deri në kilometër 25.820. Ndërmjet kilometër 19.378 dhe kilometër 19.550, shtresa e asfaltobetonit ka pësuar disa çarje të cilat duhet të riparohen.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me konsulentin, t'i kërkojnë kontraktorit të marrë masa për riparimin e ndarëseve të trafikut nga kilometri 25.23 deri në kilometër 25.820 (kontrata nr. 3). Edhe shtresat asfaltike ndërmjet kilometrit 19.378 deri kilometër 19.950 kanë pësuar dëmtime, të cilat duhet të riparohen në kohë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi ka rezultuar se pagesa e kryer për automjete është bërë pa asnjë dokument justifikues të shpenzimit të kryer si dhe pa konstatuar që automjetet e siguruar janë të reja dhe sipas specifikimeve teknike të parashikuara në kontratën me bashkimin ekonomik [REDACTED], nr. 666, datë 10/02/2012, me vlerë **132.792,84 USD** (2*34,269.12 USD, 2*19,276.38 USD, 25,701.84 USD) vlere e cila përbën dëm ekonomik.

Po ashtu, pagesa e kryer për automjete pa asnjë dokument justifikues të shpenzimit të kryer si dhe pa konstatuar që automjetet e siguruar janë të reja dhe sipas specifikimeve teknike të parashikuara në kontratën me bashkimin ekonomik [REDACTED], nr. 666/1, datë 10/02/2012, me vlerë **131,333.56 USD** (2*33,892.53 USD, 2*19,064.55 USD, 25,419.40 USD) përbën dëm ekonomik.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për ndalimin e pagesës së kryer me vlerë 264.126,4 USD në certifikatën pasardhëse, për automjetet e vendosura në dispozicion të mbikëqyrësit të punimeve, sepse nuk është shoqëruar me dokumentacionin që vërteton blerjen e tyre si më poshtë:

Me vlerë 132.792,84 USD sipas kontratës nr. 666, datë 10/02/2012

Me vlerë 131,333.56 USD sipas kontratës nr. 666/1, datë 10/02/2012

Gjatë hartimit të certifikatës progresive të punimeve

2. Janë kryer pagesa për shpenzimet e udhëtimit pa dokumentacion justifikues të shpenzimeve të kryera nga supervizori dhe pa u vlerësuar që përbejnë shpenzim aktual dhe të arsyeshëm në vlerën **11,633 USD**, pagesat e kryera janë në kundërshtim me pikën 6.2 (c) “Shpenzimet e rimbursueshme” të Kapitullit 6 “Pagesat e konsulentit” të kontratës të lidhur me [REDACTED] datë 29/07/2012, ku thuhet “rimursohet shpenzimet aktuale dhe të arsyeshme e kryera nga konsulenti”, pasi mungesa e dokumentacionit justifikues me këtë pikë të kontratës, ato nuk përbejnë një shpenzim aktual dhe të arsyeshëm.

- Janë kryer pagesa për shpenzimet e udhëtimit dhe qira pa dokumentacion justifikues të shpenzimeve të kryera nga supervizori dhe pa u vlerësuar që përbejnë shpenzim aktual dhe të arsyeshëm në vlerën **23,000 USD** në kundërshtim me pikën 6.2 (c) “Shpenzimet e rimbursueshme” të Kapitullit 6 “Pagesat e konsulentit” të kontratës të lidhur me [REDACTED] datë 24.08.2012, ku thuhet “rimursohet shpenzimet aktuale dhe të arsyeshme e kryera nga konsulenti”, pasi mungesa e dokumentacionit justifikues dhe mbi pagesa e biletave të avionit janë në kundërshtim me këtë pikë të kontratës, ato nuk përbejnë një shpenzim aktual dhe të arsyeshëm.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në certifikatën pasardhëse të zbresë pagesat me vlerë 34,633 USD, të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës nga Kompania

Konsulente [REDACTED] sipas kontratës të lidhur me datë 29.07.2012 dhe datë 24.08.2012 si më poshtë:

Me vlerë 11,633 USD sipas kontratës datë 29.07.2012,

Me vlerë 23,000 USD sipas kontratës datë 24.08.2012.

Gjatë hartimit të certifikatës progresive të punimeve

3. Gjatë realizimit të kontratës (Sauk-Tunel), për përshtatjen e standardeve janë realizuar një sërë ndryshimesh, reflektuar nëpërmjet 18 urdhër ndryshimesh.

Sipas urdhër ndryshimi nr. 8, është miratuar ndërtimi i një rruge eksesi me vlerë 18 milionë lekë, ndërkohë që është zbritur ndërtimi i rrugëve të devijimit për distancën 5 kilometër, me vlerë 3.2 milionë lekë. Ky Veprim bie në kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës Pika 1.20 dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.2 (b) ku përcaktohet: “*Përveç kur përcaktohet ndryshe në kontratë, metoda e matjeve do të bëhet në përputhje me zërat e punimeve (bill of quantities) ose skedul tjetër*”.

Në pikën 12.3 të kushteve të përgjithshme të kontratës Par. 1 dhe 2, përcaktohet:

“-*Përveç sa është cilësuar ndryshe në kontratë, Inxhinieri duhet të procedojë në përputhje me nënpikën 3.5, të miratojë ose përcaktojë çmimin e kontratës duke llogaritur çdo zë të punimeve, duke aplikuar matjet në përputhje me pikat 12.1 dhe 12.2 dhe çmimet përkatëse*”.

- “**Për një zë punimi vlere ose çmimi i përshtatshëm për të duhet të jetë vlere ose çmimi i specifikuar për këtë zë punimi në kontratë, ose nëse ky zë punimi nuk ekziston, specifikohet për zëra të ngjashëm**”. Si pasojë e veprimit të mësipërm është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **12,233,970 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit për realizimin e këtyre linjave u konstatua se, pagesa është bërë sipas propozimit të nënkontraktorit [REDACTED], dhe jo në matjet sipas faktit, veprim në kundërshtim me pikën 12.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. Nga auditimi i këtij dokumentacioni rezulton se, sipas zërit të pagesës 2.37/3 b “Transport shtylla në objekt, ngritje dhe transport me kafshë” është përshkruar sasia 123.24 ton, ndërkohë që në ofertat e paraqitura nga dy konkurrentët e tjerë kjo sasi është 110 ton. Për zërin e punimeve “Transport material betoni në objekt” është likuiduar sasia 1334.35 m³, ndërkohë që nga verifikimi i zërave të tjerë të punimeve sasia e betonit të furnizuar dhe realizuar në objekt është 840 m³. Si pasojë e veprimeve të mësipërme është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **2,535,130.8 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, vlere e likuiduar për automjetin Kamionçinë me pajisjet përkatëse është në shumën 5,923,987.3 lekë ndërkohë që vlere e paraqitur në propozimin financiar sipas urdhër ndryshimit është 5,600,000 lekë. **Vlora 388,734 lekë** (323,987.3 lekë + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Bashkëngjitur faturave të automjeteve është paraqitur edhe dokumentacioni që ka të bëjë me transport automjete dhe pajisje. Faturat e paraqitura nga operatorët nuk përputhen me operatorët që kanë kryer veprimet doganore. Si pasojë e këtyre veprimeve, për tre raste, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,014,000 lekë.

Nga verifikimi i punimeve në objekt është konstatuar se për këtë kontratë, janë likuiduar punime për ndërtimin e mureve gabione me shumë në sasinë 36 m³, duke shkaktuar dëm ekonomik **me vlerë 134,697 lekë**.

Nga verifikimi i punimeve për realizimin e sinjalistikës horizontale është konstatuar diferencë të gjatësisë së realizuar, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **575,236.8 lekë**.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën 16,881,768.6 lekë përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR], si më poshtë:

Vlera 12,233,970 lekë, si pasojë e konstatimeve të ndryshimit të kontratës (rrugëve devijuese) sipas urdhër ndryshimit nr. 8.

Vlera 2,535,130.8 lekë, rezultuar si diferencë punimesh nga realizimi i dy linjave elektrike për furnizimin me energji të Tunelit të Krrabës.

Vlera 388,734 lekë, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori për pagesë blerje kamionçine, mbi çmimin e ofruar sipas ndryshimit nr. 16.

Vlera 1,014,000 lekë, si mangësi në paraqitjen e faturave për transportin e automjeteve të blera, po sipas ndryshimit nr. 16.

Vlera 134,697 lekë, pagesë për punime të pa realizuara për ndërtim mur gabioni.

Vlera 575,236.8 lekë, likuiduar për punime të pa realizuara për realizimin e sinjalistikës horizontale të tunelit

Menjëherë

4. Nga verifikimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratës nr. 1 (Sauk-Tunel i Krrabës) në lidhje me sigurimet për palët e treta dhe punime rezulton se siguracioni është prerë për një periudhë (dy muaj) e cila është ezauruar sa i përket dëmeve. Po ashtu edhe në kontratën e sigurimit kjo periudhë nuk është mbuluar. Ky veprim bie në kundërshtim me të dhënat e Kontratës, Pika 18.1, ku përcaktohet: *“Periudha e paraqitjes së evidencës së sigurimit dhe policave përkatëse, duhet të paraqitet brenda 21 ditëve”*. Pagesa me vlerë vlera **58,656.13 USD** është e pamotivuar dhe e pa justifikuar ndaj Kontraktorit [REDAKTUAR] dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i punimeve në terren është konstatuar se, për zërin furnizim vendosje “Furnizim vendosje guardrails tip H2”, janë certifikuar dhe likuiduar punime në sasinë 7027.5 ml, ndërsa nga verifikimi i tyre në objekt rezulton se janë vendosur 5050 ml. Ky veprim bie në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Pika 12.1. Pagesa me vlerë 122,339.34 USD [(7027.5-5050 ml x 51.58 USD/ml) + TVSH], nuk është bazuar në progresin e punimeve dhe sasi të realizuara në fakt.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit “Ndërtim mur gabioni” rezulton se janë certifikuar punime ndërkohë që nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i përket dimensionit të telit të këtyre rrjetave. Nga përlllogaritjet e diferencës së peshës së rrjetave është konstatuar dëm ekonomik me vlerë **100,560.4 USD**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratës nr. 3 (Tunel i Krrabës-Elbasan) në lidhje me sigurimet për palët e treta dhe punime rezulton se, siguracioni është prerë për një periudhë (dy muaj) e cila është ezauruar sa i përket dëmeve. Po ashtu edhe në kontratën e sigurimit kjo periudhë nuk është mbuluar. Ky veprim bie në kundërshtim me të dhënat e Kontratës, Pika 18.1, ku përcaktohet: *“Periudha e paraqitjes së evidencës së sigurimit dhe policave përkatëse, duhet të paraqitet brenda 21 ditëve”*. Pagesa me vlerë 55,466 USD, është e pamotivuar dhe e pa justifikuar ndaj Kontraktorit [REDAKTUAR] dhe përbën dëm ekonomik

Nga verifikimi i skicave dhe punimeve të realizuara u konstatua se për segmentin nga kilometër 23.857 deri kilometër 29.275, janë certifikuar punime të pa realizuara në sasinë 6224 m³ mur gabioni (mur mbrojtje lumore) dhe 3513.5 m³ mur gabioni në forme jastëku. **Vlera 386,092 USD është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori për punime të pa realizuara.**

Nga verifikimi i punimeve është konstatuar se nuk janë respektuar specifikimet për rrjetat e telit që përdoren për muret gabione. Nga përlllogaritja e diferencës së peshës së tyre, është konstatuar dëm ekonomik me vlerë 25,334.4 USD [18.2 ton x 1160 USD/ton + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR] dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave për furnizimin dhe vendosjen e shtyllave për ndriçim rezultoi se, për zërin 216, 217, 218, 219, janë realizuar pagesa për vendosjen e 80 shtyllave të ndriçimit ndërkohë që janë vendosur 17 copë. Nga ana e konsulentit është justifikuar fakti se të gjitha shtyllat janë gjendje në magazinë dhe nuk janë vendosur për të përcaktuar më parë pikat e nxehta ku do të vendosen.

Vlera 37,284.1 USD [18,087.86+TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të projektit të verifikojë vlerat e punimeve të konstatuara si diferenca të certifikuar dhe likuiduar, por të pa realizuara, në favor të bashkimit të firmave [REDAKTUAR], duke bërë zbritjet në certifikatën pasardhëse të punimeve, për vlerën 785,732.37 USD, si më poshtë:

Sipas Kontratës nr. 1 “Sauk-Tuneli i Krrabës”.

Vlera 58,656.13 USD për pagesë sigurimi, për një periudhë të pambuluar me sigurim.

Vlera 122,339.34 USD, likuiduar për punime të pa realizuara për ndërtimin e guardrail.

Vlera 100,560.4 USD, për mos respektim të specifikimeve teknike, për ndërtimin e mureve prej gabioni.

Sipas Kontratës nr. 3 “Ndërtim i segmentit Tunel i Krrabës-Elbasan”.

Vlera 55,466 USD për pagesë sigurimi, për një periudhë të pambuluar me sigurim.

Vlera 386,092 USD, për punime të certifikuar por të pa realizuara për ndërtimin e mureve prej gabioni.

Vlera 25,334.4 USD, për mos respektim të specifikimeve teknike, për ndërtimin e mureve prej gabioni.

Vlera 37,284.1 USD, për likuidim të punimeve të pa realizuara në ndërtimin e shtyllave të ndriçimit

Gjatë hartimit të certifikatës progresive të punimeve

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe mendimin nr. 1, të kontratës individuale të punës nr. 847, 848 dhe 851, datë 08.09.2014, të nënshkruar midis Drejtorit të Njesisë së Zbatimit të Projektit dhe specialistëve të Njesisë së Zbatimit të projektit,

neni 2 “Masa disiplinore”, **kërkojmë nga Drejtori i Njësisë së Menaxhimit të Projektit të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:**

I. “Largim nga detyra”, për:

1. [REDAKTUAR], sepse,

- ka kryer pagesat për automjete pa asnjë dokument justifikues të shpenzimit të kryer si dhe pa konstatuar që automjetet e siguruar janë të reja dhe sipas specifikimeve teknike të parashikuara në kontratën me bashkimin ekonomik [REDAKTUAR], nr.666, datë 10/02/2012, me vlerë **132.792,84 USD** (2*34,269.12 USD, 2*19,276.38 USD, 25,701.84 USD) përbën dëm ekonomik.

- ka kryer pagesat për automjete pa asnjë dokument justifikues të shpenzimit të kryer si dhe pa konstatuar që automjetet e siguruar janë të reja dhe sipas specifikimeve teknike të parashikuara në kontratën me bashkimin ekonomik [REDAKTUAR], nr. 666/1, datë 10/02/2012, me vlerë **131,333.56 USD** (2*33,892.53 USD, 2*19,064.55 USD, 25,419.40 USD) përbën dëm ekonomik.

- ka kryer pagesa për shpenzimet e udhëtimit pa dokumentacion justifikues të shpenzimeve të kryera nga supervizori dhe pa u vlerësuar që përbejnë shpenzim aktual dhe të arsyeshëm në vlerën **11,633 USD**, pagesat e kryera janë në kundërshtim me pikën 6.2 (c) “Shpenzimet e rimbursueshme” të Kapitullit 6 “Pagesat e konsulentit” të kontratës të lidhur me [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] datë 29/07/2012, ku thuhet “rimursohet shpenzimet aktuale dhe të arsyeshme e kryera nga konsulenti”, pasi mungesa e dokumentacionit justifikues me këtë pikë të kontratës, ato nuk përbejnë një shpenzim aktual dhe të arsyeshëm.

- ka kryer pagesa për shpenzimet e udhëtimit dhe qira të zyrave pa dokumentacion justifikues të shpenzimeve të kryera nga supervizori dhe pa u vlerësuar që përbejnë shpenzim aktual dhe të arsyeshëm në vlerën **23,000 USD** në kundërshtim me pikën 6.2 (c) “Shpenzimet e rimbursueshme” të Kapitullit 6 “Pagesat e konsulentit” të kontratës të lidhur me [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] datë 24.08.2012, ku thuhet “rimursohet shpenzimet aktuale dhe të arsyeshme e kryera nga konsulenti”, pasi mungesa e dokumentacionit justifikues dhe mbi pagesa e biletave të avionit janë në kundërshtim me këtë pikë të kontratës, ato nuk përbejnë një shpenzim aktual dhe të arsyeshëm.

- Krahas zërave të tjerë, sipas kontratës së mirëmbajtjes së tunelit të Krrabës, ishte parashikuar blerja e 7 automjeteve dhe pajisjeve përkatëse për to.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, vlera e likuiduar për automjetin Kamionçinë me pajisjet përkatëse është në shumën 5,923,987.3 lekë, ndërkohë që vlera e paraqitur në propozimin financiar sipas urdhër ndryshimit është 5,600,000 lekë, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **388,734 lekë**.

Bashkëngjitur faturave të automjeteve është paraqitur edhe dokumentacioni që ka të bëjë me transport automjete dhe pajisje. Faturat e paraqitura nga operatorët nuk përputhen me operatorët që kanë kryer veprimet doganore. Si pasojë e këtyre veprimeve, për tre raste, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **1,014,000 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të sigurimit për palët e treta dhe punime rezulton se siguracioni është prerë për një periudhë (dy muaj) e cila është ezauruar sa i përket dëmeve. Po ashtu edhe në kontratën e sigurimit kjo periudhë nuk është mbuluar. Ky veprim bie në kundërshtim me të dhënat e Kontratës, Pika 18.1, ku përcaktohet: “*Periudha e paraqitjes së evidencës së sigurimit dhe policave përkatëse, duhet të paraqitet brenda 21 ditëve*”. **Sa më sipër pagesat me vlerë vlera 58,656.13 USD për kontratën nr. 1 dhe vlera 55,466 USD për kontratën**

nr. 3, janë të pamotivuara dhe të pa justifikuar nga ana e Kontraktorit duke shkaktuar dëm ekonomik.

II. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, për:

1. ██████████, sepse,

- Nga verifikimi i dokumentacionit dhe punimeve në terren për ndërtimin e dy linjave për furnizimin me energji elektrike të dy tuneleve të Krrabës diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të likuiduara, ardhur edhe si pasojë e llogaritjeve të gabuara të preventivit por edhe rezultuar nga matjet në terren. Si pasojë e veprimeve të mësipërme është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **2,535,130.8 lekë.**

- Nga verifikimi i punimeve për realizimin e sinjalistikës horizontale të realizuar për tunelin e Krrabës është konstatuar diferencë të gjatësisë së realizuar, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **575,236.8 lekë.**

- Nga verifikimi i punimeve sipas zërit “Ndërtim mur gabioni” për kontratën nr. 1, rezulton se, janë certifikuar punime ndërkohë që nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i përket dimensionit të telit të këtyre rrjetave. Nga përlllogaritjet e diferencës së peshës së rrjetave është konstatuar dëm ekonomik me vlerë **100,560.4 USD.** Nga ana e oficerit të projektit duhet të bëheshin monitorime të vazhdueshme për sigurimin e cilësisë së punimeve.

- Sipas zërit të punimeve “Furnizim vendosje guardrails tip H2”, ka rezultuar se janë certifikuar dhe likuiduar punime në sasinë 7027.5 ml, ndërsa nga verifikimi i tyre në objekt rezulton se janë vendosur 5050 ml. Megjithëse punimet janë në proces zbatimi, certifikimi i sasive të pa realizuara është në **kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Pika 12.1.**

2. ██████████, sepse,

- Nga verifikimi i punimeve është konstatuar se nuk janë respektuar specifikimet për rrjetat e telit që përdoren për muret gabione, sa i përket punimeve sipas kontratës nr. 3. Nga përlllogaritja e diferencës së peshës së tyre, është konstatuar dëm ekonomik me vlerë **25,334.4 USD.**

-Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave për furnizimin dhe vendosjen e shtyllave për ndriçim rezultoi se, për zërin 216, 217, 218, 219, janë realizuar pagesa për vendosjen e 80 shtyllave të ndriçimit ndërkohë që janë vendosur 17 copë. Nga ana e konsulentit është justifikuar fakti se të gjitha shtyllat janë gjendje në magazinë dhe nuk janë vendosur për të përcaktuar më parë pikat e nxehta ku do të vendosen.

Vlera 37,284.1 USD [18,087.86+TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori. Nga verifikimi i skicave dhe punimeve të realizuara u konstatua se për segmentin nga kilometër 23.857 deri kilometër 29.275, janë certifikuar punime të pa realizuara në sasinë 6224 m³ mur gabioni (mur mbrojtje lumore) dhe 3513.5 m³ mur gabioni ne forme jastëku. **Vlera 386,092 USD, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori për punime të pa realizuara.**

Megjithëse punimet janë në proces zbatimi, certifikimi i sasive të pa realizuara është në **kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Pika 12.1.**

E. KALLZIM PENAL

Bazuar shkeljet e konstatuara si dhe në nenet: 164 të shpërdorimit të kompetencave, 248 të shpërdorimit të detyrës dhe 258 të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande

publike të Kodit Penal, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të mësipërme, për personat si më poshtë:

1. [REDAKTUAR], në cilësinë e Ish-Drejtorit të Njësisë së Zbatimit të Projektit, sepse: Ka nënshkruar Kontratë për mirëmbajtjen e tunelit të Krrabës e cila është e ndarë nga procesi i ndërtimit të tunelit, pa realizuar proces prokurimi, por duke negociuar direkt me kontraktorin ekzistues, veprim në kundërshtim me udhëzuesin e Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) “Manuali për prokurimin e mallrave dhe punëve”, Pika 3.5.

Në pikën 3.5 “Kontratat direkte” përcaktohet:

“Kontrata direkte ose nga një burim i vetëm për përfshirje të garuesve të tjerë përfshin kontraktimin me një kontraktor ose kontraktori mund të lejohet në situatat e përcaktuara më poshtë, subjekt i miratimit paraprak të IDB:

i. Kur blihen mallra ose punime me vlerë të vogël.

ii. Kur standartizimi është i rëndësishëm ose riparimi i pajisjeve ekzistuese duhet të bëhet nga furnizuesi origjinal i pajisjes, ose nga furnizues i pajisjeve identike.

iii. Kur pajisjet janë pronë në karakter dhe përmbajtje e vetëm një prodhuesi.

iv. Kur kontraktori përgjegjës për një proces dizajnimi kërkon blerje të pajisjeve kritike nga pjesë të prodhuesit si një kusht i garancisë së performancës.

v. Kur, pas investimit të pajisjeve origjinale për një projekt kanë qenë prokuruar sipas tenderit të hapur ndërkombëtar, dhe një shtesë në sasi të zërave (mallra apo punime) të ngjashme është urgjent i nevojshëm për plotësimin e kërkesave të projektit dhe IDB duhet të sigurohet që nuk do të ketë avantazhe marrja e këtyre mallrave apo punimeve nëpërmjet konkurimit me tender të hapur ndërkombëtar (ICB) apo kombëtar (NCB).

vi. Kur punimet civile që do të merren në sipërmarrje janë natyrë zgjatje të një pune të mëparshme apo në proces, për të cilin kontrata korresponduese ka qenë nënshkruar nëpërmjet tenderit ndërkombëtar dhe kombëtar pranuar kënaqshëm nga IDB dhe kur mund të provohet tek IDB që, angazhimi i të njëjtit kontraktor do të jetë më ekonomik se sa organizimi i procedurave normale dhe do të sigurojnë pajtueshmërinë e cilësisë së punimeve”.

vii. Në raste përjashtuese, në përgjigje të një natyre të forcës madhore”.

Aplikimi i kësaj procedure ka shkaktuar pamundësinë e marrjes pjesë të operatorëve në procedurat e prokurimit publik, si dhe një trajtim jo të barabartë të tyre, **veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 1, Pika 2. ç, d.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me **VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu IV, Pika 5, iv.**

Sa më sipër, konstatohet se, nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore për aplikimin e kësaj procedure që kanë të bëjnë me:

- Shkaktimin e një ngjarje të paparashikuar.

- Autoriteti Kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen.

- Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.

- Nuk ka qenë e mundur dhe nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarde mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Shmangia e konkurrencës ka të bëjë me pamundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë, pasi kjo procedurë nuk bëhet e njohur përtej operatorëve të ftuar.

- ***Ka miratuar urdhër ndryshimi nr. 8, për ndërtimin e një rruge aksesi me vlerë 18 milionë lekë, ndërkohë që është zbritur ndërtimi i rrugëve të devijimit për distancën 5 kilometër, me vlerë 3.2 milionë lekë.*** Ky Veprim është në kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës Pika 1.20 dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.2 (b) ku përcaktohet: “*Përveç kur përcaktohet ndryshe në kontratë, metoda e matjeve do të bëhet në përputhje me zërat e punimeve (bill of quantities) ose skedul tjetër*”.

Në pikën 12.3 të kushteve të përgjithshme të kontratës Par. 1 dhe 2, përcaktohet:

“-*Përveç sa është cilësuar ndryshe në kontratë, Inxhinieri duhet të procedojë në përputhje me nënpikën 3.5, të miratojë ose përcaktojë çmimin e kontratës duke llogaritur çdo zë të punimeve, duke aplikuar matjet në përputhje me pikat 12.1 dhe 12.2 dhe çmimet përkatëse*”.

- ***“Për një zë punimi vlera ose çmimi i përshtatshëm për të duhet të jetë vlera ose çmimi i specifikuar për këtë zë punimi në kontratë, ose nëse ky zë punimi nuk ekziston, specifikohet për zëra të ngjashëm”***.

Si pasojë e veprimit të mësipërm është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **12,233,970 lekë**.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Artan Topiana, Jorida Zhegu, Ina Sokoli dhe Enida Mata, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT